



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. 148 Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 25 / 10 / 2023

VENDIM

Nr. 38 date 25 / 10 / 2023

PËR

PROJEKT IDENE E OBJEKTIT

“REHABILITIMI I DIGES SE FARKES”, TIRANE

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 “Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave” dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 “Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave”, Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 25.10.2023 mori në shqyrtim Projekt Idene e paraqitur nga Bashkia Tirane për Rehabilitimin e Diges së rezervuarit të Farkes e cila administrohet nga kjo Bashki. Kjo dige me lartësi 29 m është ndertuar në vitin 1984 dhe ka bërë të mundur krijimin e një rezervuari me volum uji aktual prej 8.36 milion m³. Prej me se 20 vitesh, diga nuk është e monitoruar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për shkak të mungesës së instrumentave të sistemeve të monitorimit të dige. Sipas bashkësive të Tiranës, në dige vërehen probleme në lidhje me funksionimin e sistemit të shkarkimit të diges, sistemin e drenazhimit në anën e poshtme të diges, filtrimet në anën e poshtme dhe rreshqitje të vogla sipërfaqësore në anën e poshtme të diges.

Projekt Ideja e paraqitur është përgatitur nga firma konsulente NET GROUP shpk. Sipas kësaj projekti ideje janë parashikuar punime për sistemin e drenazhimit dhe punime përforcuese në anën e poshtme të diges, punime për riparimin e sistemit të shkarkimit dhe vepres së marrjes së ujit, punime për kabinën e rojes, rehabilitimin e bordurave dhe qendrueshmerinë e skarpateve si dhe punime për FV të sistemeve të monitorimit gjedoezik, hidraulik, hidrogjeologjik dhe HM në dige. Gjithashtu, Në projekt ide janë parashikuar edhe punime speciale për mbrojtje me pilota si dhe për cimentimin e berthames së diges.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur rezulton se projektuesit kanë përgatitur një relacion teknik të shoqruar me studimet perkatese topografike, batimetrike, gjeologjike, sizmike, , hidrogjeologjik, hidrologjik si dhe me VNM, analizen e vales vërsuese, analizen e qendrueshmerisë statike dhe dinamike të diges dhe Planin e gadishmerisë në rastet e emergjencave civile duke plotësuar në përgjithësi kërkesat e ligjit Nr. 8681 dhe të VKM Nr. 147 të mesipërme. Sipas konkluzioneve të llogaritjeve të qendrueshmerisë së diges rezulton se qendrueshmeria e skarpateve nga forcat hidrostetike të Diges Farkes identifikohen në gjendje ekuilibri të qendrueshme. Analiza statike e sforcimeve totale identifikon vlera të cilat krahasuar me ato të cilat jepen në studimin gjeologo-inxhinierik janë brenda vlerave të lejuara. Analiza dinamike ka identifikuar zvogëlim të faktorit të sigurisë për skarpatat e poshtme dhe të sipërme të Diges Farkë krahasuar me vlerat statike, por identifikohen në gjendje ekuilibri në kufijt të qendrueshmerisë duke konsideruar forca shtesë të termetit me periudhë përsëritje 495 vjet. Projektuesit konstatojnë mungesën e të dhënave të monitorimit për të gjithë periudhën e shfrytëzimit të kësaj dige dhe me të drejtë kërkohet një monitorim në kohe reale dhe me instrumenta të sjelljes së trupit të diges, filtrimeve si dhe të niveleve dhe prurjeve të ujit në rezervuarin e krijuar prej saj. Gjithashtu, projekti përfshin rezultatet e matjet batimetrike për volumn aktual të ujit në rezervuar të kryera në vitin 2023 si dhe informacionin në lidhje me njëzërit në rrezik poshtë diges, etj .

Këshilli Teknik i Përhershëm i Digave (KTPD) dhe SKDM i rekomandoi antareve të KKDM të miratoj pjesërisht projekt Idene e paraqitur për nderhyrjet e parashikuara në lidhje me rehabilitimin e përgjithshëm të diges dhe instalimin e sistemeve të monitorimit dhe të mos miratoj punimet speciale të kërkuara në këtë projekt në lidhje me mbrojtjen me pilota, cimentimin e berthames së diges e cimentimit në trupin e diges dhe punimet e gjelbërimit në anën e poshtme të diges.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

Pas diskutimeve të të gjithë antarëve të pranishëm, KKDM

VENDOSI:

- 1- **Të Miratoj Projekt Idene per Rehabilitimin e Diges se Farkes ne lidhje me punimet e emergjente te rehabilitimit te diges te parashikuar ne projekt per sistemin e drenazhimit dhe punimet perforcuese ne anen e poshtme te diges, punime per riparimin e sistemit te shkarkimit dhe vepres se marrjes se ujit, rehabilitimin e bordurave dhe qendrueshmerine e skarpateve, punime per kabinen e rojes si dhe punime per FV te sistemeve te monitorimit gjedoezik, hidraulik, hidrogeologjik dhe HM ne dige. Njekohesisht, te mos miratoj punimet speciale ne dige te parashikuara ne projekt ne lidhje me mbrojtjen me pilota dhe cimentimet ne barthamen e diges per shkak te mungeses se te dhenave te monitorimit te filtrimeve dhe sjelljes se diges, konkluzionit te projektuesve ne baze te analizes se qendrueshmerise se diga paraqitet brenda vlerave te lejuara te ekuilbrit si dhe per shkak te mungeses se standarteve teknike per keto punime speciale.** Punimet speciale mund te kryhen ne nje faze te dyte pas marrjes se te dhenave te monotorimit per te pakten nje vit si dhe nje analize te hollesishme te ketyre te dhenave dhe sjelljes se diges pas kryerjes se punimeve te emergjences te permenduar me siper
- 2- Ti kerkoj Bashkise Tirane dhe firmes projektuese qe gjate pregatitjes se projekt zbatimit perkates I bazuar mbi kete projekt ide, duhet te perfshihet **Instalimi i nje sistemi alarmi ne dige** sipas kerkesave te nenit 35 te VKM Nr. 147, date 18.03.2004 te mesiperme;
- 3- Ti kerkoj Bashkise Tirane dhe firmes projektuese qe gjate pregatitjes se projekt zbatimit per rikonstruksionin e shkarkuesit **te kontrollohet permasimi i kapacitetit te shkarkuesit per shkarkimin e prurjeve ditore qe mund te vijne ne kete rezervuar nje here ne 1000 vjet.**
- 4- Ti kerkohet Bashkise Tirane qe projekti i zbatimit per rehabilitimin e diges se Farkes per fazen e emergjences te miratuar me siper dhe i plotesuar sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi, te dorezohet per miratim prane KKDM perpara fillimit te punimeve ne terren. Projekti duhet te jete I shoqeruar edhe me Rregulloren e shfrytezimit, Operimit, monitorimit dhe sigurise se Diges ne kushtet e reja te shfrytezimit te saj per atraksion urban dhe turistik ,
- 5- Ti kerkoj Bashkise Tirane qe **para fillimit te punimeve te merren masat per boshatisjen e rezervuarit si dhe te marre miratimin e KKDM per mbikqyresin e punimeve te caktuar prej saj** sipas legjislacionit te mesiperm.
- 6- Ti kerkoj Bashkise Tirane qe te dorezoj prane KKDM, kerkesen per miratim te ndryshimit te destinacionit te perdorimit te diges se Farkes nga dige per qellim kryesor ujitjen e tokave ne dige me qellim kryesor per atraksion urban dhe turistik. Kerkesa duhet te shoqerohet edhe me rregulloren perkatese per Operimin, monitorimin dhe sigurine e diges ne kushtet e reja te perdorimit te saj.

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kerkuara në kete vendim sipas legjislacionin në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI

Arjan JOVANI

